REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJË

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Nr._____Prot. Lushnjë 08 / 04 / 2025

Lënda: *Plotësime mbi kërkesën për oponence të objektit:"Urbanizim I bllokut të banimit në Lagjen Xhevdet Nepravishta, rruga Ahmet Shabani"*

INSTITUTIT TË NDËRTIMIT
DREJTORISË SË RREGULLAVE TEKNIKE DHE OPONENCAVE

TIRANË

Në përgjigje të email-it tuaj dërguar në adresën zyrtare të Bashkisë Lushnje mbi plotësime ne oponencën e objektit *:"Urbanizim i bllokut të banimit në Lagjen Xhevdet Nepravishta, rruga Ahmet Shabani"më poshtë do të gjeni:*

1- Detyrën e Projektimit të miratuar edhe firmosur nga zhvilluesi

Studimi gjeologo-inxhinierik i sheshit të ndërtimit; nuk është kryer pasi në këtë zonë është parashikuar kryerja e urbanizimit të zonës , përmes punimeve të ndërtimit të rrugëve dhe shesheve ekzistuese pa ndërhyrje në thellësi për ndërtim apo përforcime themelesh. Thellësia më e madhe e gërmimit (skarifikimi) është 20cm. Nga projekte të mëparshme ne kemi informacion mbi strukturën gjeomorfologjike të zonës. Mbizoterojne strukturat antiklinale per depozitimet neogenike (izoipsi 50-100) . Këtu kemi depozitime nderthurje ranoro-argjilore dhe zhavoro -konglomeratike. dhe per fushen (izoipsi 20 deri 50) eshte structure kuaternarit me shtrirje horizontale ku mbizoterojne sedimentet e shkrifeta dhe te imeta argjilo - ranor e copezor. Ketu kemi keto formacione SUITA RROGOZHINA -N_2 ,(alevrolitore - argjilore-konglomeratike) . SHKEMBINJTE MBULESOR - KUATERNARI shkembinj te pa Formesuar edhe te pakonsoliduar me depozitime eluvionale e deluvionale .



2- **Studimi topografik i objektit**

Projekti është hartuar mbi bazën e nje topografie me kuota relative të vendosura në rrugë dhe sheshet ku do të ndërhyhet. Zgjidhja e projektit ruan topografine e zones. Profili gjatësor ruan pjerrësinë ekzistuese

3- Raporti hidrologjik e klimaterik i zonës si dhe llogaritjet hidraulike


Zona shtrihet ne nje klime mesdhetare pergjithesisht e lagesht edhe jo te ftohte ne periudhen e dimrit edhe me temp larta ne periudhen e veres. Temperatura mesatare shumevjecare eshte 10° dhe vlerat minimale dhe maksimale jane perkatesisht -0°dhe +41°.

Intensiteti i rreshjeve me siguri 20 %, 1 here ne 5 vjet per zonen, t= 10', eshte 19.5 mm ose 117 mm/ore, per t=24 ore 110 mm. Ngricat jane kryesisht ne muajt dhjetor-shkurt, rralle here mund te kete shtrese akulli. Ererat qe fryjne nuk e kalojne shpejtesine 30÷50 km/ore, me drejtime te ndryshme por dominues është drejtimi veri-perendeim-jug-lindje. Lageshtira e ajrit është e madhe ne dimer dhe vere e nxehtë qe karekterizohet nga nje ulje e ndjeshme e lageshtires se ajrit, gje qe bene te nevojshme marrjen e masave per sperkatje me uje te rrugeve

Nga pikëpamja ambientale sheshi ndertimit ka dendesi mesatare . Ndaj kryerja e punimeve te parashikuar (rruge , sheshe , kanalizm kub) do te ulte nivelin e ndotjes .

- Zgjedhja e sistemit te kanalizimit te ujrave te bardha eshte menduar me linje fi 400 mm (sek rrethor) me puseta kontrolli sepse per shkak te pjerresise natyrale eshte e mundur vetepastrimi ne menyre natyrale edhe pa kosto te shtuar ne fuqi punetore.

• Llogaritja hidraulike e tubacioneve të sistemit të kanalizimit të ujrave atmosferike Llogaritja hidraulike e kanalizimit të ujrave atmosferike bëhet duke u bazuar në formulën e Manning për tubacionet. Në këtë rast janë pranuar si të njohura diametri i tubacionit si dhe pjerrësia, e cila përcaktohet sipas profilit gjatësor (shih vizatimet), e më pas është kontrolluar kapaciteti i tubacionit. Më poshtë jepet seksioni tërthor i rrjedhës së bashku me formulat llogaritëse . Forma e sek kanalit per tubacionin fi 400 mm



$$F=\frac{w}{x}=\frac{\pi d^2}{4\pi d}=0.25d$$


Per dimensionin tubacionit fi 400 hdpn

$$Q = \frac{A}{n} x\, R_h^{\frac{2}{3}} x\, S^{\frac{1}{2}}$$

$$\theta = 2\cos^{-1}(1 - \frac{2h}{D})$$

$$A = \frac{D^2}{8}(\theta - sin\theta)$$

$$R_h = \frac{D}{4}(\frac{\theta - sin\theta}{\theta})$$



Prurja e Shiut + etj	m3/s	0.013	0.3
Shpejtesia	m/s	3.2	8.6
Rrezja Hidraulike	m	0.02	0.07
Sip	m2	0.00	0.03
Koef Manningut		0.011	0.011

Duke bazuar ne keto te dhena sdm prurjet ne piken kritike (0.3 m3/s) eshte vendosur perdorimi i tubacionit fi 400 mm hdpn .

Ing. Artur Sinani

DREJTOR

Mimoza Haxhiu